Phonak Vitus+

ITE

Udhëzimet e përdorimit

A Sonova brand

PHONAK
life is on

Ky udhëzues përdorimi është i vlefshëm për:

Modelet me valë	**Marka CE u aplikua në:**
Phonak Vitus+ ITE-312	2018
Phonak Vitus+ ITE-13	2018

Modelet pa valë	**Marka CE u aplikua në:**
Phonak Vitus+ ITE-10 NW O	2018

CE 0459

Detajet e aparatit tuaj të dëgjimit:

ⓘ Në rast se asnjë kuti e mëposhtme nuk është shënuar dhe ju nuk e njihni modelin e aparatit tuaj të dëgjimit, ju lutemi pyesni profesionistin tuaj të kujdesit të dëgjimit.

Modelet:	**Madhësia e baterisë:**
☐ Phonak Vitus+ ITE-10 NW 0	10
☐ Phonak Vitus+ ITE-312	312
☐ Phonak Vitus+ ITE-13	13

Specialisti juaj i dëgjimit:

Aparatet tuaja të dëgjimit janë prodhuar nga Phonak – lideri botëror në zgjidhjet e dëgjimit me bazë në Zyrih, Zvicër.

Këto produkte premium janë rezultat i punëve kërkimore dhe ekspertizës së gjatë dhe janë krijuar për t'ju mbajtur të lidhur me bukurinë e zërit! Ju falenderojmë që keni bërë një zgjedhje kaq të mrekullueshme dhe ju urojmë dëgjim të këndshëm.

Ju lutemi, lexoni me kujdes udhëzimin e përdorimit dhe sigurohuni që i kuptoni, para se të filloni të përdorni aparatin tuaj të dëgjimit. Për më shumë informacione rreth veçorive, benefiteve, konfigurimeve, përdorimit dhe mirëmbajtjes ose riparimeve të aparatit tuaj të dëgjimit, kontaktoni audiologun tuaj.

Phonak – life is on
www.phonak.com

Përmbajtja

Aparati juaj i dëgjimit

1. Guidë e shpejtë 6
2. Pjesët e aparatit të dëgjimit 8

Përdorimi i aparatit të dëgjimit

3. Shenjat dalluese për aparatin e majtë ose të djathtë të veshit 10
4. I ndezur/ I fikur 11
5. Bateria 12
6. Vendosja e aparatit të dëgjimit (të gjitha modelet) 14
7. Heqja e aparatit të dëgjimit 15
8. Butoni i shtypjes 17
9. Kontrolli i volumit 18

Informacione shtesë

10. Kujdesi dhe mirëmbajtja 19
11. Aksesorët me valë 22
12. Servisi dhe Garancia 24
13. Compliance information 26
14. Information and description of symbols 28
15. Zgjidhja e problemeve 32
16. Informacione të rëndësishme rreth sigurisë 34

1. Guidë e shpejtë

Shenjat për aparatin e majtë dhe të djathtë të dëgjimit

Majtas

Djathtas

Shenja blu
për **aparatin e majtë.**

Shenja e kuqe
për **aparatin e djathtë.**

Ndërrimi i baterisë



Hiqeni letrën
ngjitëse
nga bateria
e re dhe prisni
2 minuta

Hapeni derën
e baterisë



Vendoseni baterinë
në derën e saj
me simbolin «+»
të kthyer nga lart.

I ndezur/ I fikur



I ndezur



I fikur

Butoni i shtypjes



Vetëm modelet me këtë opsion:
Butoni i shtypjes në aparatin tuaj
të dëgjimit mund të ketë funksione
të ndryshme

Kontrolli i volumit të zërit



Vetem modelet me këtë opsion:
Për ngritjen e volumit të zërit, ktheni
kontrolluesin e volumit të zërit
në drejtim të orës. Për zvogëlim
volumi zëri, ktheni kontrolluesin
në drejtim të kundërt të orës

2. Pjesët e aparatit të dëgjimit

Fotografitë e mëposhtme ju tregojnë modelet e përshkruara në këtë udhëzues përdorimi. Ju mund të identifikoni modelin tuaj personal:

- duke kontrolluar «Detajet e aparatit tuaj të dëgjimit» në faqen 3, ose
- duke krahasuar aparatin tuaj të dëgjimit me modelet e mëposhtme.

Vitus+ ITE-10 NW 0



Vitus+ RIC-312T



Vitus+ RIC-312T



3. Shenjat dalluese për aparatin e majtë ose të djathtë të veshit

Ka një shenjë të kuqe ose blu, për të dalluar nëse është aparati i majtë apo i djathtë i dëgjimit. Ngjyrat dalluese vihen re brenda sirtarit të baterisë.

Ngjyra blu është dalluese
për **veshin e majtë.**

Ngjyra e kuqe është dalluese
për **veshin e djathtë.**

4. I ndezur/ I fikur

Dera e baterisë ka gjithashtu funksion ndezës/fikës.

1

Dera e mbyllur e baterisë = aparati i dëgjimit është **i ndezur.**



2

Dera e hapur e baterisë = aparati i dëgjimit është **i fikur.**

ⓘ Kur ju ndizni aparatin e dëgjimit, mund të dëgjoni një melodi fillestare.

5. Bateria



Hiqeni letrën ngjitëse nga bateria e re dhe prisni 2 minuta

Hapeni derën e baterisë.



Vendoseni baterinë në derën e saj me simbolin «+» të kthyer nga lart.

ⓘ Nëse keni vështirësi të mbyllni derën e baterisë, kontrolloni që bateria është vendosur saktë dhe simboli «+» të jetë i kthyer lart. Nëse bateria nuk është vendosur siç duhet atëherë aparati nuk do të funksionojë dhe dera e baterisë mund të dëmtohet.

Bateria në përfundim: Do të dëgjoni 2 sinjale «bip» kur bateria e aparatit të jetë në përfundim. Keni rreth 30 minuta kohë për të ndërruar baterinë (kjo ndryshon nga lloji i aparateve të dëgjimit dhe nga bateria).

Ne ju rekomandojmë që të keni gjithmonë me vete një bateri të re.

Ndërrimi i baterisë

Ky aparat dëgjimi kërkon bateri me zink-ajër. Gjeni madhësinë e saktë të baterisë (10, 312 ose 13) duke:

- Iu referuar «Karakteristikat e aparatit të dëgjimit» në faqen 3
- Duke kontrolluar shenjën në anën e brendshme të derës së baterisë
- Duke ju referuar tabelës së mëposhtme.

Modeli Phonak Vitus+	**Madhësia e baterisë me zink-ajër**	**Ngjyra shenjës në pako**	**Kodi IEC**	**Kodi ANSI**
ITE-10 NW 0	10	e verdhë	PR70	7005ZD
ITE-312	312	kafe	PR41	7002ZD
ITE-13	13	portokalli	PR48	7000ZD

ⓘ Ju lutemi përdorni llojin e saktë të baterisë për aparatin tuaj të dëgjimit (me Zink-ajër). Po ashtu lexoni kapitullin 16.2 për informata shtesë rreth sigurisë së pajisjes.

6. Vendosja e aparatit të dëgjimit (të gjitha modelet)

1

Afrojeni aparatin tuaj të dëgjimit në afërsi të veshit dhe futeni brenda sic tregohet në figurë.



7. Heqja e aparatit të dëgjimit

7.1 Heqja e aparatit të dëgjimit nëpërmjet fillit tërheqës.

1

Kapeni fillin tërheqës dhe me kujdes tërhiqeni lart dhe pastaj jashtë veshit.



7.2 Heqja e aparatit të dëgjimit pa fill tërheqës

1

Vendoseni gishtin e madh
në llapën e veshit dhe lehtë
shtypeni aparatin e dëgjimit
jashtë veshit. Për ta
ndihmuar këtë, bëni lëvizjen
e përtypjes me nofullën tuaj.



2

Kapeni aparatin e dëgjimit
dhe hiqeni atë.



8. Butoni i shtypjes

Vetëm modelet me këtë opsion:
Butoni i shtypjes në aparatin tuaj të dëgjimit mund të ketë funksione të ndryshme ose të jenë joaktive. Kjo varet nga programimi i aparatit të dëgjimit, që tregohet në «Instruksionet e aparatit tuaj të dëgjimit». Ju lutemi, kërkoni këtë udhëzim përdorimi nga audiologu juaj.





9. Kontrolli i volumit

Vetëm për modelet me këtë opsion:
Për rritje të volumit të zërit, ktheni kontrolluesin e volumit në drejtim të orës. Për zvogëlim të volumit, ktheni kontrolluesin në drejtim të kundërt të orës. Kontrolluesi i volumit të zërit mundet të jetë i caktivizuar nga audiologu juaj.



10. Kujdesi dhe mirëmbajtja

Kujdesi i shpeshtë në rutinën tuaj të përditshme, ndihmon në performancën dhe jetëgjatësinë e aparatit.

Për të siguruar një jetë të gjatë shërbimi, Sonova AG ofron të paktën 5 vite shërbim pas përfundimit të prodhimit të aparatit të dëgjimit përkatës, shiko kapitullin 16.2

Informacion i përgjithshëm
Përpara se të përdorni llak për flokë ose produkte kozmetike, duhet të hiqni aparatin e dëgjimit nga veshi, sepse këto produkte mund ta dëmtojnë aparatin.

Çdo Ditë:
Kontrolloni kufjen nëse ka mbetur dyll veshi apo depozitime lagështie dhe pastrojeni me një leckë të pastër. Asnjëherë mos përdorni agjentë pastrimi shtëpiakë si detergjentë, sapun etj. për pastrimin e aparatit tuaj. Nuk rekomandohet shpëlarja me ujë. Nëse keni nevojë ta pastroni intensivisht aparatin e dëgjimit, kërkoni disa këshilla dhe informacione nga audiologu juaj për filtrat ose kapsulat e pastrimit.

Çdo javë:
Për udhëzime më të thella rreth mirëmbajtjes ose për më shumë se pastrimi bazë, ju lutemi drejtohuni tek audiologu juaj.

Mbrojtësi ndaj dyllit
SmartGuard është një mbrojtës unik ndaj dyllit të veshit i konceptuar nga Phonak. Dizajni i veçantë i membranës mbron plotësisht aparatin tuaj të dëgjimit ndaj dyllit dhe lagështisë.



Mrojtësit ndaj dyllit «cerustop» si alternativë akoma aplikohen. Ju lutemi drejtohuni audiologut tuaj për informata më të hollësishme rreth sistemit mbrojtës ndaj dyllit tek aparati juaj i dëgjimit.

11. Aksesorët me valë

11.1 Komunikimi në zhurmë dhe në distancë

Portofoli Roger ofron një performancë të shkëlqyeshme të mikrofonit duke ju ndihmuar të kuptoni më mirë në zhurmë dhe në distancë. Me Roger ju mund të përfitoni:

- Kuptimin e çdo fjale në situata të zhurmshme si p.sh. në restorante, hapësira publike dhe në distanca të gjata
- Dizajni diskret
- Transmetimi i fjalëve direkt në aparatin tuaj të dëgjimit me marrës të bashkangjitur ose përmes një marrësi tuaj të veshur në trup



Opsioni me marrës në trup

Vini re: Në dispozicion vetëm për modelet me telecoil.

- Disa mikrofonë të Roger gjithashtu mbështesin të dhëna nga burimet audio përmes Bluetooth® ose kabllo. Bluetooth® është shenjë dalluese në pronësi të Bluetooth SIG, Inc.

12. Servisi dhe Garancia

Garancia lokale
Ju lutemi pyesni audiologun tuaj rreth kushteve
të garancisë lokale.

Garancia internacionale
Sonova AG ofron granaci ndërkombëtare njëvjeçare
të kufizuar, të vlefshme nga data e blerjes. Kjo garanci
e kufizuar mbulon defektet gjatë prodhimit dhe defektet
materiale në vetë aparatin e dëgjimit, por jo aksesorët
si bateri, tuba, kufje dhe marrës të jashtëm. Garancia vlen
vetëm kur dëshmohet blerja e posaçme.

Garancia ndërkombëtare nuk ndikon në asnjë të drejtë
ligjore që mund të keni sipas legjislacionit nacional i cili
rregullon shitjen e mallrave konsumatore.

Kufizimi i garancisë

Kjo garanci nuk mbulon dëmet e shkaktuara nga trajtimi i papërshtatshëm ose moskujdesi, ekspozimi ndaj kimikateve ose keqtrajtimi fizik. Dëmet e shkaktuara nga palët e treta ose servisi në qendra të paautorizuara e bëjnë garancinë të pavlefshme.

Numri serial
(ana e majtë)::

Profesionisti i dëgjimit
(vula / firma):

Numri serial
(ana e djathtë):

Data e blerjes:

13. Compliance information

Europe:

Declaration of Conformity

Hereby Sonova AG declares that this product meets the requirements of the Medical Devices Directive 93/42/EEC as well as the Radio Equipment Directive 2014/53/EU. The full text of the EU Declaration of Conformity can be obtained from the manufacturer or the local Phonak representative whose address can be taken from the list on www.phonak. com (Phonak worldwide locations).

Australia/New Zealand:

R-NZ

Indicates a device's compliance with applicable Radio Spectrum Management's (RSM) and Australian Communications and Media Authority (ACMA) regulatory arrangements for the legal sale in New Zealand and Australia. The compliance label R-NZ is for radio products supplied in the New Zealand market under conformity level A1.

Radio information of your wireless hearing aid

Antenna type	Integrated ferrite coil antenna (inductive)
Operation frequency	10.6 MHz
Occupied bandwidth (99% BW)	approx. 500 kHz
Modulation	DQPSK
Channel	Single channel radio
Operating range	18 cm (7")
Use case	Streaming of audio or command signal to receiving hearing aid on the other ear
Magnetic field strength @ 3 m	–20.5 dBµA/m

14. Information and description of symbols

CE XXXX	With the CE symbol, Sonova AG confirms that this product – including accessories – meets the requirements of the Medical Devices Directive 93/42/EEC as well as the Radio Equipment Directive 2014/53/EU. The numbers after the CE symbol correspond to the code of certified institutions that were consulted under the above-mentioned directives.
	This symbol indicates that the products described in these user instructions adhere to the requirements for an applied part of Type B of EN 60601-1. The surface of the hearing aid is specified as an applied part of Type B.
	Indicates the medical device manufacturer, as defined in EU Directive 93/42/EEC.

	During transportation keep dry.
	This symbol indicates that it is important for the user to read and take into account the relevant information in these user guides.
	This symbol indicates that it is important for the user to pay attention to the relevant warning notices in these user guides.
	Important information for handling and product safety.
Operating conditions	The product is designed such that it functions without problems or restrictions if used as intended, unless otherwise noted in these user guides.

SN	Indicates the manufacturer's serial number so that a specific medical device can be identified.
REF	Indicates the manufacturer's catalogue number so that the medical device can be identified.
	Temperature during transportation and storage: –20° to +60° Celsius (–4° to +140° Fahrenheit).
	Humidity during transportation: Up to 90% (non condensing). Humidity during storage: 0% to 70%, if not in use. See instruction in chapter 16.2 regarding drying the hearing aid after use.

	Atmospheric pressure: 200 hPA to 1500 hPa
	The symbol with the crossed-out garbage bin is to make you aware that this hearing aid may not be thrown away as normal household waste. Please dispose of old or unused hearing aids, at waste disposal sites intended for electronic waste, or give your hearing aid to your hearing care professional for disposal. Proper disposal protects the environment and health.

15. Zgjidhja e problemeve

Problemi	Shkaqet
Aparati i dëgjimit nuk funksionon	Bateri e dobët
	Altoparlant apo kufje e bllokuar
	Bateria nuk është vendosur saktë
	Aparati i dëgjimit nuk është i ndezur
Aparati i dëgjimit fishkëllen	Aparati i dëgjimit nuk është vendosur korrekt
	Ka dyll në kanalin e veshit
Aparati ka zë të pamjaftueshëm ose është i dëmtuar	Volumi shumë i lartë
	Bateri e ulët
	Altoparlant apo kufje e bllokuar
	Volumi shumë i ulët
	Gjendja fizike e dëgjimit ka ndryshuar
Aparati jep 2 tone «bip»	Shenjë e baterisë së ulët
Aparati ndizet dhe fiket (me shkëputje)	Lagështi tek bateria ose aparati i dëgjimit

ⓘ Nëse problemet vazhdojnë, kontaktoni audiologun tuaj për këshilla profesionale.

Çfarë duhet të bëni
Ndërroni baterinë (kapitulli 1 + 5)
Pastroni pjesën e hapur të altoparlantit
Vendoseni baterinë saktë (kapitulli 1 + 5)
Ndizeni aparatin e dëgjimit duke e mbyllur plotësisht derën e baterisë (kapitulli 4)
Vendoseni aparatin e dëgjimit saktë (kapitulli 6)
Kontaktoni ENT/GP ose audiologun tuaj
Uleni volumin (kapitulli 8 + 9)
Ndërroni baterinë (kapitulli 1 + 5)
Pastroni pjesën e hapur të autoparlantit/kufjes
Rrisni volumin nëse aparati i dëgjimit ka kontrollues volumi (kapitulli 8 + 9)
Kontaktoni audiologun tuaj
Ndërroni baterinë brenda 30 minutave (kapitulli 1 + 5)
Fshijeni baterinë dhe aparatin e dëgjimit me një leckë të thatë.

16. Informacione të rëndësishme rreth sigurisë

Ju lutem lexoni informacionet në faqet në vijim para përdorimit të aparatit tuaj të dëgjimit.

Një aparat dëgjimi nuk të rikthen dëgjimin normal dhe nuk të parandalon ose përmirëson dëgjimin e demtuar nga kushtet organike. Përdorimi i pakët i një aparati dëgjimi nuk lejon përdoruesin të përfitojë plotësisht prej tij. Përdorimi i një aparati të dëgjimit është vetëm pjesë e reabilitimit dhe duhet të plotësohen me trajnime audituese dhe instruksione
në leximin e buzëve

16.1 Paralajmërim rreziku

⚠ Përdorimi i synuar i aparateve të dëgjimit mundëson transmetimin e zërit në veshët dhe me anë të kësaj kompenson humbjen e të dëgjuarit. Aparatet e dëgjimit (të programuar individualisht) duhen përdorur vetëm nga personi me nevojë. Ata nuk duhet të përdoren nga asnjë person tjetër pasi mund të shkaktojnë dëme në dëgjimin e tyre.

⚠ Ndryshime ose modifikime tek aparatet e dëgjimit të cilat nuk janë miratuar në mënyrë eksplicite nga Sonova AG nuk lejohen. Ndërhyrje të tilla mund të dëmtojnë veshin ose aparatin tuaj të dëgjimit.

⚠ Mos i përdorni aparatet e dëgjimit në zonat shpërthyese (miniera apo zona industriale me rrezik shpërthimi, mjedise të pasura me oksigjen ose zona ku trajtohen anestetikë të ndezshëm).

⚠ Bateritë e aparateve të dëgjimit janë toksike nëse ato gëlltiten! Mbajini ato larg fëmijëve, individëve me aftësi të kufizuar dhe kafshëve shtëpiake. Nëse bateritë janë gëlltitur, konsultohuni menjëherë me mjekun!

⚠ Nëse ndjeni dhimbje në ose prapa veshit, nëse lëkura është skuqur ose irrituar, apo përjetoni akumulim të përshpejtuar të dyllit, ju lutem konsultohuni me audiologun apo mjekun tuaj.

⚠ Programet e mikrofonit drejtues reduktojnë zhurmat në sfond.
Ju lutemi kini kujdes që sinjalet paralajmëruese ose zhurmat që vijnë nga prapa, p.sh. automjetet, janë pjesërisht ose tërësisht të zhdukura.

⚠ Ky aparat dëgjimi nuk është i dedikuar për fëmijët nën moshën 36 muajshe. Ajo përmban pjesë të vogla që mund të shkaktojnë mbytje nëse gëlltiten nga fëmijët. Ruajini larg fëmijëve, individëve me aftësi të kufizuara dhe kafshëve shtëpiake. Nëse ato janë gëlltitur, atëherë konsultohuni me audiologun apo mjekun tuaj menjëherë.

⚠ Mos lidhni aparatin tuaj të dëgjimit në asnjë mënyrë me kabllo tek çfarëdo burimi audio si radio etj. Kjo mund të shkaktojë lëndime trupore (shok elektrik).

⚠ Teksti në vijim vlen vetëm për personat me implante mjekësore aktive (si aparat zemre, defibrilatorë, etj):

- Mbani aparatin e dëgjimit me valë të paktën 15 cm (6 inç) larg implantit aktiv. Nëse përjetoni ndonjë pengesë, mos përdorni aparatet e dëgjimit me valë dhe kontaktoni prodhuesin e implantit aktiv. Ju lutemi, vini re se ndërhyrja mund të shkaktohet gjithashtu edhe nga kabllo të energjisë elektrike, shkarkime elektrostatike, detektorë metali në aeroporte etj.
- Mbajini objektet magnetike së paku 15 cm larg nga implanti aktiv.

⚠ Shmangni përplasjet e forta fizike kur mbani aparatet e dëgjimit në vesh. Stabiliteti i aparatit të dëgjimit brenda veshit është krijuar për përdorim normal. Një ndikim i fortë fizik në vesh (p.sh. gjatë sportit) mund të shkaktojë thyerjen e aparatit të dëgjimit brenda veshit. Kjo mund të çojë në perforim të kanalit të veshit ose daulles së veshit.

⚠ Pas stresit mekanik ose goditjes në aparatin e dëgjimit, ju lutemi sigurohuni që guaska e aparatit të dëgjimit të jetë e paprekur përpara se ta vendosni në vesh.

16.2 Informacione rreth sigurisë së produktit

ⓘ Asnjëherë mos e zhytni aparatin tuaj të dëgjimit në ujë! Mbrojeni atë nga lagështia e tepruar. Gjithmonë hiqeni aparatin tuaj të dëgjimit përpara dushit, lajres ose notit, pasi ai përmban pjesë të ndjeshme elektronike.

ⓘ Mbrojeni aparatin tuaj të dëgjimit nga nxehtësia (mos e lini asnjëherë afër dritareve apo në automjet). Asnjëherë mos përdorni një mikrovalë ose pajisje të tjera për tharjen e tij. Kërkoni këshilla rreth tharjes së aparatit tuaj të dëgjimit nga audiologu juaj.

ⓘ Kur nuk përdorni aparatin tuaj të dëgjimit, lini derën e baterisë hapur,që çdo lagështi të zhduket. Sigurohuni që të thani gjithnjë plotësisht aparatin tuaj të dëgjimit pas përdorimit. Ruajeni aparatin e dëgjimit në një vend të sigurt, të thatë dhe të pastër.

ⓘ Mos e hidhni aparatin tuaj të dëgjimit! Rënia në një sipërfaqe të fortë mund ta dëmtojë atë seriozisht.

ⓘ Gjithmonë përdorni bateri të reja për aparatin tuaj të dëgjimit. Nëse një bateri rrjedh, zëvendësoni atë menjëherë me një të re për të shmangur çdo irritim të lëkurës. Ju mund ti ktheni bateritë tek audiologu juaj.

ⓘ Bateritë e përdorura në këto aparate të dëgjimit nuk duhet të tejkalojnë 1,5 Volt. Ju lutemi mos përdorni bateri me argjend-zink ose Li-ion (litium-jon) rimbushëse pasi këto mund të shkaktojnë dëme të rënda tek aparati juaj i dëgjimit. Tabela në kapitullin 5 shpjegon saktësisht se cili lloj i baterisë i përshtatet aparatit tuaj të dëgjimit.

ⓘ Hiqeni baterinë kur nuk përdorni aparatin tuaj të dëgjimit për një periudhë të gjatë kohore.

ⓘ Ekzaminime speciale mjekësore apo dentare duke përfshirë edhe rrezatimet e përshkruara më poshtë, mund të ndikojnë negativisht në funksionimin korrekt të aparatit tuaj të dëgjimit. Hiqini ato dhe mbajini jashtë dhomës së ekzaminimit para se ti nënshtroheni:

- Ekzaminimit mjekësor ose dentar me X-ray (gjithashtu CT scan).
- Ekzaminimit me MRI /NMRI, të cilat gjenerojnë fushë magnetike.
- Aparatet e dëgjimit nuk kanë nevojë të hiqen kur kaloni portat e sigurisë (aeroporte etj). Nëse në këto situata përdoret X-ray, ajo do të jetë në doza aq të ulëta, sa që nuk do të ndikojë në funksionimin e aparatit të dëgjimit.

ⓘ Mos përdorni aparatet tuaja të dëgjimit në zonat ku pajisjet elektronike janë të ndaluara.

Shënime

Specialisti juaj i kujdesit të dëgjimit:

029-0563-90/V1.00/2023-07/nlg/SB © 2017 Sonova AG All rights reserved

Prodhuesi:
Sonova AG
Laubisrütistrasse 28
CH-8712 Stäfa
Švýcarsko
www.phonak.com

sonova
HEAR THE WORLD

CE 0459